

UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI JURIDIK



STUDIME POSTDIPLOMIKE-MASTER

KUSHTETUES - ADMINISTRATIV

Tema:

“Të dhënat personale dhe mbrojtja e tyre sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës”

Mentori:

Prof. Ass. Dr. Flamur Hyseni

Studenti:

Habib Sinani

Prishtinë, 2023

ABSTRAKTI

Qëllimi kryesor i studimit është duke analizuar legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës të kuptohet më saktë rëndësia e mbrojtjes së të dhënave personale, që në nenin 36 paragrafi 4 Kushtetuta e Republikës së Kosovës na garanton që “Secili person gëzon të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale”. E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale nuk ka si qëllim të saj pengimin e përpunimit të të dhënave, përkundrazi ajo synon të siguroj lëvizjen e tyre të lirë, si dhe mbrojtjen e personave nga mbledhja e pajustificuar, ruajtja, përdorimi dhe përhapja e detajeve personale.

Në këtë punim kemi analizuar legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, ku të dhënat personale rregullohen me ligj të veçantë, ligjin nr. 06/L-082 për mbrojtjen e të dhënave personale, i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat ndëshkuese lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë së individit.

Ky punim shtjellon në mënyrë të detajuar përkufizimin e të dhënave personale, elementet, llojet, mbrojtjen e të dhënave personale, parimet e përpunimit të të dhënave, kriteret për zbatimin e përpunimit të të dhënave personale, si dhe të drejtat e subjektit të të dhënave.

Ky punim identifikon edhe Agjencinë për Informim dhe Privatësi, e cila është agjenci e pavarur dhe përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për mbrojtje të të dhënave personale, me qëllim që të mbrohen të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.